



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:244582

Datë: 19.09.2024

Numri i dokumentit: 06179633

C.nr.3659/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, me praktikanten D.O. në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.Ç. nga Prizreni me numër personal 1007421687, të cilën me autorizim e përfaqëson av.B.K. nga Prizreni, kundër të paditurës (AAPARr), në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar, vlera e kontestit 3,560.75 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 19.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Ç. nga Prizreni, kundër të paditurës (AAPARr), në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Prishtinë, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar.

II. DETYROHET e paditura, që paditësit, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 01.08.2021 deri më datë 31.01.2023 apo për 18 muaj (për çdo muaj shumën prej 84.45 euro, në shkallë prej 35% të pagës 495.30 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1,520.19 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 06.11.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET si e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit A.Ç. nga Prizreni, përtej shumës së gjykuar si nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë iu refuzua shuma prej 2,040.56 euro.

IV. DETYROHET e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 144.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi A.Ç. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.B.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 06.11.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës (AAPARr), në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditësi është punëtor i arsimit pranë Institucionit Arsimor Qendra e Kompetencës në Prizren. Meqenëse paditësi është e licencuar dhe e ka kualifikimin e mësimdhënësit në nivelin master/doktorature me diplomë fakulteti, në bazë të nenit 7 të kontratës kolektive të datës 18.04.2017, të njëjtit i është garantuar e drejta në pagesën shtesë prej 35% të pagës bazë, çka e paditura këtë shtesë e paguan pjesërisht. Paditësi realizon pagën bazë prej 660.97 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 35% e kësaj page apo shuma prej euro 231.33 e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë në shumën prej 88.90 euro, duke i mbetur borxh shumën prej 142.43 euro, që nga data 01.08.2021 deri me datë 31.01.2023 dhe ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet padia dhe kërkesëpadija e paditëses, të detyrohet e paditura që në emër të diferencës së pagesës shtesë për kualifikim të pa bazuar në shumën prej 3.560.75 euro, me kamatë ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura duke mbështetur në Vërtetimet e punësimit të lëshuar nga e paditura. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës në prishtinë, në buxhetin e vitit 2021 nuk ka pas buxhet për kompensimin e kësaj pagese, bazuar në nenin 46 të Kontratës Kolektive Nr.01B/2056 të dt.18.04.2017. Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit nuk na mundësojnë lejimin dhe buxhetimin për këtë kategori ekonomike, mirëpo deri më tani kjo nuk ka ndodhur, po ashtu paditësit nuk kanë ofruar asnjë dëshmi sa i përket kualifikimit nga marrëshënja e punës. Bazuar në nenin 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) Prishtinë: Viti V /Nr.90/01 dhjetor 2010) Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet, andaj konsiderojmë se gjykata duhet të marrë parasysh këtë dispozitë ligjore të Ligjit të punës të cituar më lartë. Bazuar në nenin 47 të Kontratës së Re Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr. 01B/105 e dt.22.10.2021 Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056 e dt. 18.04.2017. është shfuqizuar dhe nuk është më në fuqi, dhe se e njëjta nuk ka fuqi prapavepruese. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pjesërisht aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi A.Ç. është në marrëdhënie pune, si mësimdhënëse pranë Institucionit Arsimor “Qendra e Kompetencës” në Prishtinë. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar.

Në këtë drejtim, gjykata, nga vërtetimi nr. 5/228 i dt. 31.10.2023 u vërtetua se paditësi që nga data 29.05.2014 punon pranë Institucionit Arsimor Qendra e Kompetencës në Prizren. Nga vendimi nr. 25/1 i dt. 14.01.2022 paditësi emërohet ushtrues detyre i zëvendës drejtorit për zhvillim profesional dhe bashkëpunim me biznese në Qendrën e Kompetencës në Prizren. Kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar në nivelin doktor, fakt i cili vërtetohet edhe nga diploma me numër 220, e datës 08.12.2014, e lëshuar nga Universiteti i SHT. Kliment i Ohridski në emër të paditësit, ndërsa nga vendimi nr. 612/29 i dt. 25.05.2015 lëshuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë paditësit i është njohur grada Doktor në Sv. Kliment Ohridski në Maqedoni dhe ka licencë te karrierës. Bazuar në listën e pagave të lëshuar

nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në koeficient prej 7.8 i barasvlershëm me shumën prej 495.30 euro bazuar në Përgjigjen e dhënë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 11.12.2023 dhe se paditësit në emër të kualifikimit doktoraturë në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 88.90 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *“shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarra apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia falë besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që *“për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”*, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës, rezultoi se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar pjesërisht dhe atë shumën prej 88.90 euro nga shuma prej 173.35 euro paditësit.

Sipas pikës 4 nën pikën 2 të Vendimit nr.25/1 të datës 14.01.2022, paditësi përfiton ngritje prej 35% të pagës bazë 495.30 euro apo 173.35 euro të mbetura të papaguar shumën prej 84.65 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 84.45 euro apo diferencën e mbetur, për 18 muaj nga data 01.08.2021 deri më datë 31.01.2023, në shumën të përgjithshme prej 1,520.19 euro, duke e llogaritur sipas pagës bazë në shumën prej 495.30 euro ($18 \times 84.45 = 1520.19$).

Sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vlerësoi se paditësi në bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, pagës bazë e realizon në koeficient prej 7.8 i barasvlershëm me shumën prej 495.30 euro bazuar në Përgjigjen e dhënë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 11.12.2023 dhe jo siç ka kërkuar paditësi me padi, kompensimin në emër të ngritjes së pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit në pagën prej 660.97 euro, andaj gjykata të njëjtat ia llogariti kompensimin mbi

bazën e kualifikimit apo licencimit në pagën prej 495.30 euro, me ç ‘rast iu refuzua pjesën e kërkesës në shumë të përgjithshme prej 2040.56 euro

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga 7 faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 144.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 40 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.3659/2023, të datës 19.09.2024

Gjyqtarja

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.